



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 nr 351-24156/20
Date 27.08.2020

KONTRATA PUBLIKE nr. 050/2020

, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; Nr Biznesi 07000032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

dhe

ADI TE CONSTRUCTION SHPK , Nga ISTOGU me seli ne ISTOG Komuna ISTOG , Nr. Biznesi numer Fiskal 811224592 , qe perfaqesohet nga pronari z. FAZE MAHAJ

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për PUNET në vijim:

RENOVIME LOT 1- RENOVIME NE QKMF , NE SALL TE KONFERENCAVE -ZHVP DHE NE MJEKESI FAMILAJARE DHE SPECIALISTIK

me numër identifikues: 634-20-3225-5-2-1/INT.634-20-47-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e PUNEVE- në vijim:



Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)
1	Demolimi i mureve ekzistuese në katin e tretë , muret me trashësi t=25 cm,hapja e hapësirave për dyer të caktuara në projekt dhe nga organi mbikëqyrës në cmim të përfshihet dhe transporti deri në deponi të caktuar nga organi mbikëqyrës.	2.006	30.00	M2	60.18
2	Demolimi i dyshemesë me keramika dhe me linoleum në dy dhoma në Qkmf. Në cmim të përfshihet puna e prerjes, hudhja ne deponi të caktuar.	2.006	20.00	M2	40.12
3	Demontimi i dyreve në katin e tretë dimensione 100x210 cm dhe gjatë demontimit të kihet kujdes në mos dëmtimin e derës pasi të njëjta do të përdoret përsëri.	30.090	3.00	COPE	90.27
4	Furnizimi dhe muratimi i mureve me gips pllake në pjesën e dhomave, muret e dhëna me projekt me dimensione 3.25x2.80 m; 3.25x2.85m; suvatimi i këtyre mureve me llaq, vendosja e rrjetes, gletim dhe lyerje me polikollor me ngjyrë të caktuar nga organi mbikëqyrës. Në cmim të përfshihen materiali lidhës dhe fugat.	30.090	20.00	M2	601.80
5	Furnizimi dhe montimi i qeramikës në dy dhomat dhe me ngjyrë dhe dizajn të caktuara nga organi mbikëqyrës, në çmim të llogariten fugat dhe ngjitësi si dhe ngjitja vertikale në mure 5cm.	11.989	20.00	M2	239.776
6	Montimi i dyerve të demotuara më pare në dy dhomat e Qkmf-së.	10.018	2.00	COPE	20.036

7	Furnizimi dhe montimi i paneleve nga xhami adekuate për ndarje nëpër spitale me dimensione 325 280 në dy ndamjet e korridorit në katin e tretë. Duhet të jenë të vendosura në dysheme dhe në plafon me konstruksion metalik të kene hapjen për dere për qarkullim nga njera ane në tjetren të përforcuara mire më gjitha elementet tjera percjellese .Për qdo pakjartesi shiko foton. Duhet të jetë ngjajshme sikur në foto xhami duhet të jetë asi lloje qe mos te shihet as nga ana jashtme as nga ana mbrendeshme.	100.005	2.00	COPE	200.01
8	Furnizimi, transporti dhe montimi i xhamave (xhama qe vendosen mbi sportelet e spitale) me dimensione 8x1.80m ; si dhe montimi nje dere komplet xham me dimensione 0.80x3.00m ; në pjesen e sportelit. Lidhja me shtylla ekzistuese të betonit dhe muret ekzistuese.	200.010	1.00	COPE	200.01
9	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriqes në dhoma dhe në disa vende tjera të nevojshme në çmim përfshihet furnizimi me kabull adekuate dhe kyqja në rrjetin elektrik, paisja me ndërpreresit adekuat si dhe montimin 10 prizave, siguresave automatike, si dhe material i imet lidhes dhe montues i pa specifikuar.	20.001	1.00	COPE	20.001
10	Demolimi i mureve ekzistuese në katin e tretë , muret me trashësi t=25 cm, hapja e hapësirave për dyer të caktuara në projekt dhe nga organi mbikëqyrës në çmim të përfshihet dhe transporti deri në deponi të caktuar nga organi mbikëqyrës.	2.006	60.00	M2	120.36

11	Demolimi i dyshemesë me keramika dhe me linoleum në sallën e konferencave në Qkmf. Në çmim të përfshihet puna e prerjes, hudhja ne deponi të caktuar.	2.006	70.00	M2	140.42
12	Demontimi i dyreve ne sallën e konferences në katin e tretë dimensione 1.85x2.80 cm dhe 3.20x2.80 cm gjatë demontimit të kihet kujdes në mos dëmtimin e derës pasi e njëjta do të përdoret përsëri.	10.018	2.00	COPE	20.036
13	Furnizimi dhe muratimi i mureve me gips pllake në dhomen e konferences, muret e dhëna me projekt me dimensione 3.25x2.80 m; 1.0x2.85m; suvatimi i këtyre mureve me llaq, vendosja e rrjetes, gletim dhe lyerje me polikollor. Në çmim të përfshihen materiali lidhës dhe fugat.	30.007	12.00	M2	360.089
14	Furnizimi dhe montimi i qeramikës në sallën e konferences dhe formë dhe ngjyrë të caktuara nga organi mbikqyrës, në çmim të llogariten fugat dhe ngjitësi.	11.989	70.00	M2	839.216
15	Furnizimi transporti dhe montimi plafonit me pllaka amstrong të cilat janë me material gipsi I plastifikuar nga jashtë dhe I mbeshjtjellur me foli alumini nga mbrapa të jetë rezistent ndaj ujit ,në sallën e konferences të përfshihen elementet përforcuese shinat për vëndosjen e amstrogut këndet bulonat rrjeta si dhe elementet tjera percjellese.	20.001	70.00	M2	1,400.07
16	Furnizimi me 70 karrika , kualitative te pershtatshme per salle te konferences te cilat duhet te kene edhe tavolinen dyshe(ne formatin sipas fotos).Për qdo pakjartesi shiko foton.Për qdo pakjartesi shiko foton	30.031	70.00	cope	2,102.17

17	Tavolina pune - 35 standarde kualitative te pershtatshme per salle te konferencave te cilat duhet te kene edhe tavolinen dyshe(ne formatin sipas fotos).Për qdo pakjartesi shiko foton.Për qdo pakjartesi shiko foton	50.008	35.00	cope	1,750.294
18	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriques në sallën e konferencës sipas organit mbikqyres në çmim përfshihet furnizimi me kabull adekuate dhe kyqja në rrjetin elektrik,paisja me ndërpreresit adekuat si dhe montimin 20 prizave,siguresave automatike,si dhe material i imet lidhes dhe montues i pa specifikuar.	100.005	1.00	cope	100.005
19	Furnizimi, transporti dhe montimi i folieve (reklamave) me dim 3.00x1.80m; 3.25x1.80m; 1.65x0.95m në dritaret ekzistuese dyer dhe në muri sipas projektit,foliet (reklammat) të jenë me ngjyrë dhe dizajn të përzgjedhur nga organi mbikqyres.	9.995	50.00	m2	499.73
20	Furnizimi, transporti dhe lyerja e sipërfaqeve ë mureve dhe tavanit me ngjyrë polikollor yndyror ne dy shtresa, në llogari të hyjë edhe riparimi i pjesëve të dëmtuara, riparimi me rrjetë i mureve dhe tanvanit i këndeve të dëmtuara, plasaritjeve dhe këndëve të shtyllave si dhe rreth dyerve dhe dritareve ne sallën e konferencës.	4.991	100.00	m2	499.14

1.2. Vlera Totale e Kontrates me TVSH dhe taksa tjera eshte 9.303,73€
(Nentemijetreqindetrecuroe73/100)

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i perditeshem sipas përshkrimit te detyrave nga neni 1 i kësaj kontrate eshte **25 dite pune** .

2.2 Vendi i kryerjes së puneve sipas Projektit ne QKMF NENE TERZA.Kline :

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 1.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kryesit të punimeve sipas kontratës publike.

3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike .

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

3.5.Dhe atë me fature dhe Raport mbi kryerje të punëve , Jo më larg se 30 dite pas pranimit të fatures dhe Raportit .

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3. Pagesat do të ekzekutohen me keste sipas dinamike së kryerjeve të punimeve

Pagesat do të behen sipas situacineve mbi kryerje të punimeve me Raport nga Komisioni dhe Fatura.Jo më tepër se 30 dite pas pranimit të fatures dhe Raportit .

- *Pas Pgages finale do të kerkohet garancioni . afati të Garancionit të punimeve , perkatesisht pas 12 muajeve .*

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

6.2. Kryesi i punëve do të jete përgjegjës për Demtimet të shkaktuara me dashje apo pa kujdesi në masen e demit që do të përcaktohet nga zyrtari përgjegjës .

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Në rastet deshtimit apo voneses në Implementim, do të penalizohet me masën 0.25% në ditë vonesë nga vlera totale e kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, dhe të shikoj furnizimet e bera nëse është në masën e cilesive të kërkuara.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet të japë Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

12.2 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



Neni 6. Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i kontratës.

6.1. Menxhimi i projektit do te behet nga njesia kerkuese –Implementuese Drejtoria SHENDETESISE Komuna Kline

6.2 .Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrtaes me vendim te ZKA do te jete : _____ nga _____



6.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues
KOMUNA KLINE**

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27.08.2020
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve :

ADI TE CONSTRUCTION SHPK – ISTOG .

Emri:	ASTRIT SYLAJ
Pozita:	PRONAR 1 AUTORITAR
Nënshkrimi:	
Data:	27.08.2020
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që bën Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuba dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cilin është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguroesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguroesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmerisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngrije të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngrijës së tatimeve dhe/ose ngrijës së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëherë nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkakuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2 Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3 Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4 Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës; (i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës; (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmblyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryejë një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 **Obigimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet të kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 **Dëmet e Likuiduara**

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrersë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet të behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbim parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe rritënderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emer të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutimin të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rrezikjet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se pritet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së leshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura pëmbajtëse ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i pëmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Neni 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike komizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/apo

b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <u>DREJTORIA E SHENDETESISE – BARTES I PROJEKTIT</u> <u>MENXHER I KONTRATES ESHTË</u> <u>NGA</u> <u>Drejtoria</u>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10 % vlerës se kontrates, PERKATESISHTE VLERA 930.37. € ME AFATE 25+30=55 dite kalendarik
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: <ul style="list-style-type: none"> a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates b) Përgjegjësia e pales së tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates d) Përgjegjësia profesionale 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues te kontrates
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësise së Defekteve është gja tere kohes se Validiteit te Kontrates.
Afati i Implementimit	17.2	Plani i plementimit te projektit 25 dite pune .
Mos realizimii apo sanksionet	17.3	Per cdo dite vonese do te sanksionohet 0.25% ng vlera e kontrates per dite vonese.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Do te përpiqet qe me pajtueshmëri te dy paleve te zgjidhen problemet .
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>Gjykata Themelore Peje – Dega Kline</i> në pajtim me ligjin në Kosovë, ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta kenë

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 86029

Për **KUVENDI KOMUNAL-KLINË**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **ADI TE CONSTRUCTION SHPK**

(emri dhe adresa e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **RENOVIME LOT 1-Renovime ne QKMF, ne sallë të Konferencave-ZHVP dhe ne mjekësi Fmijare dhe Specialistik**

Nr. prokurimit: 634-20-3225-5-2-1 , Nr. brendshëm: 634-20-047-521

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues,

dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **930.37€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmimeve të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **930.37€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 55 ditë kalendarike prej **27.08.2020** deri më **21.10.2020**

Data lëshimit: 27.08.2020

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Nr i Sensë

0051137



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A / Insurance Company I.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a. Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismaj" -nr.3,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115. E-mail: office@graweelsig.com

Gjithcka që duhet ta kenë

Nr. Policës
Policy no.

86029

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË TENDERIT DHE EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS BID BOND AND PERFORMANCE BOND POLICY

Kontraktuesi: ADI TE CONSTRUCTION SHPK

Përfaqësuar nga: Faze Mahaj

Adresa: LIDHJA E PEJES, CARRALLUKE ISTOG Istog

Nr. i Biznesit: 811224592 Nr. i telefonit:

Garantuesi: Elsig

Banka e Garantuesit: NLB

Përfituesi: KUVENDI KOMUNAL-KLINË

Adresa: KLINË

Shuma e Sigurimit: 930.37 Numri i Marrëveshjes:

Aktiviteti Ekonomik: RENOVIME LOT 1-Renovime ne QKMF, ne sallë të Konferencave-ZHVP dhe ne mjekësi Familjare dhe Specialistik

Data e fillimit: 2020-08-27 00:00:00 Data e përfundimit: 2020-10-21 00:00:00 Ora: 00:00:00

Primi: 20.00 TVSH: 3.60 Gjithsej: 23.60

Mënyra e pagesës: Ne llogari Nr. i llogarisë: 1701001011295733

Data e lëshimit: 2020-08-27 08:52:05

Lënda e garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Policë të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit / Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit / Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për policat të sigurimit - Egzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatorit Egzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Nr i Serisë

0051137

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit të rrujë të dhënat e mia personale/të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari mirëkuptohet dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit. My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions.

2241

Siguruesi / The Insurer

I Siguruari / The Insured

https://www.elsig.com/signatures/045947



Emri - Name / Nënshkrimi - Signature 1/1



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
 Ministry of Trade and Industry

ARBK

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
 CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
 CERTIFICATE OF REGISTRATION

811224592

Nënrri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

ADI TE CONSTRUCTION SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Tipi i biznesit:
 Poslovni tip
 Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
 Društvo sa ograničenom odgovornošću
 Limited Liabilities Companies

Adresa:
 Adresa
 Address:

Lidhja e Pejës
 Carrallukë
 Istog

Data e regjistrimit:
 Datum registracije
 Date of registration:

04/02/2016

06/06/2019

Baza / Date / Datum



[Handwritten Signature]
 Nënskrimi / Signature / Potpis

Ser. / Ser. br. / Ser. No.: **10033088**

NJOFTIM PËR AKTIN NOTERIAL

Zyra Noteriale në Istog,
RR. "Fadil Ferati" nr.65/1
Adem Gorani – Noter
Tel fix. (039/450-800)

Nr.rend.529/2016

Data: 10.02.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER
ADEM GORANI
ISTOG

LRP Nr. 529/2016

-----**AUTORIZIM BIZNESI**-----

Me datën: 10.02.2016(dhjetë shkurt dymijë e gjashtëmbëdhjetë) para meje, e poshtë I nënshkruari Adem Gorani, noter në Istog, Rr. "Fadil Ferati"nr.65/1, me kërkesë dhe në bazë të deklaratës së vullnetit të lirë, të përpilojë shënimin (aktin) noterial **mbi Autorizimin Gjeneral të Biznesit**, u paraqitë personalisht pronari i kompanisë: -----

Ndërmarrja "ADI TE CONSTRUCTION" SH.P.K, e regjistruar pranë MTI me numër regjistrim biznesit 71241939, me numër fiskal 601578232, me seli në fshatin Carallukë K.Istog, e përfaqësuar nga pronarja:-----
Z. Faze Mahaj, e lindur më 06.12.1989(gjashtë dhjetor njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë), në Pejë, me vendbanim në fshatin Carrallukë K.Istog, me numër personal 1232988971, shtetase e Kosovës, identitetin e të cilës e kam vërtetuar në bazë të letërnjoftimit numër ID03439353, të lëshuar nga MPB Rep. Kosovës me datën 11.03.2011, me datën e skadimit 11.03.2016.-----

Me këtë **AUTORIZIM** unë: **Faze Mahaj**; si pronare e ndërmarrjes "**ADI TE CONSTRUCTION**", me të dhënat e lartcekura, **AUTORIZOJMË**:-----
Astrit Sylaj, i lindur më 24.01.1982(njëzet e katër janar njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy), në fshatin Carallukë K.Istog, ku edhe banon , me numër personal 1013430345, shtetas i Kosovës, bartës i letërnjoftimit numër ID03401534, të lëshuar nga MPB Rep. Kosovës me datën 19.01.2011, me datën e skadimit 19.01.2021, që në emër të ndërmarrjes "**ADI TE CONSTRUCTION**", të ndërmarr këto veprime procedurale: -----

1. Të kryej te gjitha punët e duhura administrative lidhur me zhvillimin e ndërmarrjes "**ADI TE CONSTRUCTION**", pranë të gjitha organeve në nevojë si atyre Komunale dhe atyre Qendrore të Republikës së Kosovës. -----
2. Të lidhë dhe nënshkruaj çfarëdo lloj Kontrate, në cilëndo cilësi për Shitblerjen e gjësendeve tjera të cilat janë prone e ndërmarrjes, si dhe t'i kryej të gjitha procedurat në lidhje me doganimin dhe zhdoganimin e tyre dhe të nënshkruaj marrëveshje bashkëpunimi ne emër të ndërmarrjes pranë Gjykatës Kompetente apo Noterit, të pranojë dhe kryej pagesa ne emër të llogarisë bankare të ndërmarrjes "**ADI TE CONSTRUCTION**", të nënshkruaj dhe arrijë ujdinë për çfarëdo lloj Kontrate si (Shitblerje, Qiraje etj.). -----
3. Në emër të ndërmarrjen, të nënshkruajë çfarëdo lloj **Kontrate Kredie** apo bashkëpunimi me të gjitha bankat që veprojnë brenda dhe jashtë vendit, për çfarëdo lloj Produkti, tërheqjen dhe deponimin e të hollave, si dhe në rast nevojë Hapje dhe Mbyllje të llogarive. -----



4. Të përfaqësoj ndërmarrjen, pranë Gjykatës dhe të gjitha Institucioneve ku ajo është palë në procedurë. -----
 5. Të paguaj tatimin në qarkullim si dhe obligimet tjera komunale ne emër dhe llogari te ndërmarrjes. -----
 6. Të përfaqësoj Ndërmarrjen në të gjitha procedurat kontestimore dhe jokontestimore. -----
 7. Të përfaqësoj ndërmarrjen, brenda dhe jashtë vendit. -----
 8. T'i autorizoj dhe bart autorizimin, për shfrytëzimin e veturave tek punonjësit e ndërmarrjes. -----
 9. Të paguaj tatimin në qarkullim si dhe obligimet tjera komunale ne emër dhe llogari te ndërmarrjes. -----
 10. Të kryej te gjitha punët e duhura administrative lidhur me zhvillimin e biznesit te "ADI TE CONSTRUCTION", pranë Doganave të Kosovës dhe të ekzekutoj të gjitha procedurat rreth doganimit dhe shpeditimit. -----
 11. Që të përfaqësojë ndërmarrjen "ADI TE CONSTRUCTION", pranë organeve kompetente të KEDS-it dhe KEK-ut; Ujësullësit Rajonal, Termokos-it, Post Telekomit të Kosovë, si dhe pranë organeve kompetente .-----
- Të gjitha veprimet te cilat do ti ndërmerr i AUTORIZUARI në kontekst të këtij AUTORIZIMI i pranoi dhe i konsideroi sikur ti kisha ndërmarrë vet. -----
- Ky AUTORIZIM vlen në kohë të pacaktuar derisa e njëjta nuk revokohet nga dhënësi i Autorizimit. Siç u cek me sipër, AUTORIZIMI u përpilua dhe redaktua, konform vullnetit të AUTORIZIMDHENESIT, i cili pasi e lexoi, ishte dakord me përmbajtjen e AUTORIZIMIT dhe të njëjtin e nënshkroi pa vërejtje para meje, unë si Noter vërtetoj tërësisht aktin dhe nënshkruaj në bazë të ligjit. --
- Shpenzimet janë paguar nga pala në vlerë prej 20.00 € + 18% TVSH, bazuar në Nenin 21 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale bazë për pagesën e shërbimit të noterëve. -----
- Ky akt është i përpiluar ne 2 (dy) faqe dhe 2 (dy) flet. -----
- Akti është përpiluar pa ndërprerje dhe në praninë të palëve në zyrën e noterit, sot më datën: 10.02.2016(dhjetë shkurt dymijë e gjashtëmbëdhjetë). -----

DHËNËSIT E AUTORIZIMIT:

Ndërmarrja "ADI TE CONSTRUCTION",
të cilën e përfaqëson pronarja;

Faze Mahaj





PLANI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

Sipas Nenit 81.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

Data e përgatitjes së PMK¹ 27.08.2020

Përgatitur nga: **vendos emrin dhe mbiemrin e Menaxherit të Projektit të AK-**

-DREJTOR I DREJTORISE KOMUNALE E SHENEDETESISSE DHE MIREQENJES SOCIALE

Numri i Prokurimit	634-20-3225-521		
Titulli i Kontratës	<u>RENOVIMI NE OKMF -NE SALL TE KONFERRENCAVE -ZHVP NE MJEKESI FAMILJARE DHE SPECIALISTIK</u>		
Punë/Shërbime/Furnizime	Viti Buxhetor	Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit	
PUNE	2020	ABAZ FONIQI	

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT Afatet 25 DITE PUNE VLERA. 9.303.73 €
Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Vendos Nuk Aplikohet për ato që nuk janë relevante	
I. Fillimi/ Mobilizimi i Kontratës	
Njoftimi për fillimin e punës/shërbimeve/furnizimit të mallrave	ME DATE 01.09.2020
Afati i përmbushjes	<u>PLANI IMPLAEMENTIMIT -25 DITE PUNE</u>
Pranimi i garancisë së performancës dhe lirimi i sigurimit të tenderit	PO SIGURIMI I KONTRATES NE VLERE 930.37 EURO ME VALIDITET 25+30=55 DITE

¹ Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plan i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Pranimi i garancisë së pagesës në avans, nëse është e aplikueshme	<i>SKA AVANS</i>
Pagesa e avansit , nëse është e aplikueshme	<i>SKA</i>
Dorëzimet e para Shërbimet: raporti fillestarë Punët: instalimi i parë	
Shuma e dëmeve të likuiduara përfshirë kufizimin e dëmeve të likuiduara	
Periudha e përgjegjësisë për defekte	
II. Progresi i Kontratës	
Dorëzimet e Mëtutjeshme Shërbimet: raportet e progresit etj. Punët: instalimi i dytë etj.	
Bisedimet e Rregullta, nëse është e aplikueshme	
Inspektimi i punëtorive, materialeve dhe vendeve të prodhimit	
Pagesat e përkohshme apo në faza, nëse është e aplikueshme	
Reduktimi i garancive, nëse është e aplikueshme	<i>Ska avans</i>
III. Përmbyllja e Kontratës	
Dorëzimet Finale Shërbimet: Raporti Final Punët: Përfundimi i Punëve	
Pranimi/ dorëzimi	
Pagesa e Fundit	
Fondet e mbajtura	
Skadimi i garancionit/periudha e përgjegjësisë	
Lirimi i garancisë	

Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Kontratës²:

Në emër të Autoritetit Kontraktues ; KK KLINE -DREJTORIA KOMUNALE E SHENDETESISE

Nënshkrimi: _____

Emri: ANTON SHLLAKU

Pozita: DREJTOR

Data: _____

Në emër të [Kontraktuesit/Ofruesit të Shërbimeve - ADI TE CONSTRUCTION - ISTOG

Emri: FAZE MAHAJ

Nënshkrimi:

Pozita:

Data:

NGA A.K.

DORUNTINA DUSHI

MENAXHER I KONTRATE NGA O.E, ASTRIT SYLAJ

² Të nënshkruhet nga dy Menaxherët e Projektit